



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.36/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Krenar Berisha, në çështjen juridike përbarimore të kreditorit “Balkan Dairy Kosovo” ShPK me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson zyra ligjore Boga&Associates me avokat S.E., D.N. dhe A.B. nga Prishtina, kundër debitorit “Auloni” ShPK me seli në zona industriale p.n. Fushë Kosovë-Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2343/22 të datës 30.10.2023, me datë 28.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e kreditorit “Balkan Dairy Kosovo” ShPK me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2343/22 i datës 30.10.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2343/22 të datës 30.10.2023, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Auloni” ShPK, ka anuluar Urdhrin Përbarimor P.nr.337/22, të datës 23.09.2022, të lejuar nga Përbaruesi Privat Kushtrim Metaj dhe Përfundohet në tërësi përbarimi në këtë çështje përbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesja e autorizuar e kreditorit “Balkan Dairy Kosovo” ShPK me seli në Prishtinë, për shkak të konstatimit gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të Gjykata Komerciale e Kosovës –Dhomat e Shkallës së Dytë ta pranoj ankesën si të bazuar më ligj dhe fakte, dhe ta anuloj Aktvendimin KPPP nr.2343/22 datës 30.10.2023 të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë.

Përgjigjen ne ankesë ka paraqitur debitori i cili kundërshton në tërësi ankesën e kreditorit dhe i propozon gjykatës së ankesën e kreditorit ta refuzoj si të pathemelt, ndërsa aktvendimin e Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2343/22 të datës 30.10.2023, ta vërtetoj

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit

nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Balkan Dairy Kosovo” ShPK me seli në Prishtinë, me datën 20.09.2022 ka paraqitur propozim për përmbartim, kundër debitorit “Auloni” ShPK, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave për shumën e borxhit prej 34,857.27€.

Përmbartuesi Privat Kushtrim Metaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Balkan Dairy Kosovo” ShPK me seli në Prishtinë, ka caktuar urdhrin P.nr.337/2022 të datës 20.09.2022 duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturave nr.00054/2020 të datës 18.11.2020, fatura 00056/2020 datë 02.12.2020, fatura 00057/2020 datë 09.12.2020, fatura 00058/2020 e datës 15.12.2020, fatura 00059/2020 e datës 22.12.2020, fatura 00001/2021 e datës 05.01.2021 në shumë totale prej 34,857.27€, dhe debitori ti paguaj shpenzimet përmbartimore.

Debitori në prapësim e paraqitur, kundërshton në tërsi urdhrin përmbartimor me pretendimin se faturat në bazë të së cilës është lejuar përmbartimi, nuk është i përshtatshëm për përmbartim, pasi që faturat e lëshuara nga kreditori nuk ka nënshkrim të pranuesit të mallit dhe as vulë të debitorit, gjykatës i propozon që ta aprovoi si të bazuar prapësimin dhe ta shfuqizoj urdhrin përmbartimor.

Në përgjigjen në prapësim kreditori kundërshton në tërsi prapësimin e debitorit si të pabazuar. Faturat në bazë të cilave është paraqit propozimi për përmbartim janë dokument i besueshëm dhe i plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore, i propozon gjykatës që prapësimi të hedhet poshtë dhe të lejohet procedura përmbartimore.

Gjykata Komerçiale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2343/22 datës 30.10.2023 me të cilin e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Auloni” ShPK, ka anuluar Urdhrin Përmbartimor P.nr.337/22, të datës 23.09.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Metaj dhe ka Përfunduar në tërësi përmbartimin në këtë çështje përmbartimore.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se dokumenti i besueshëm- fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se faturat janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk mund të vërtetohet se të njëjtat janë pranuar nga debitori, përkatësisht faturat nuk përmbajnë nënshkrimin e pranuesit – debitorit, nuk përmbajnë vulën e pranimit dhe nuk ka dëshmi se të njëjtat janë pranuar nga debitori në ndonjë mënyrë tjetër. Gjykata vendimin e referon në nenin 29 par.1 pika 1.3, nenin 37 të LPP-së.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerçiale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i

atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbarimore apo kontestimore nga neni 182 të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkalles së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike kur ka konstatuar se faturat në bazë të së cilave është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se faturat janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk mund të vërtetohet se të njëjtat janë pranuar nga debitori, përkatësisht faturat nuk përmbajnë nënshkrimin e pranuesit – debitorit, nuk përmbajnë vulën e pranimit dhe nuk ka dëshmi se të njëjtat janë pranuar nga debitori në ndonjë mënyrë tjetër.

Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se fatura si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbarimore, respektivisht është lejuar përmbarimi, nuk i plotëson kushtet në mënyrë komulative që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret është edhe qëndrim i kësaj gjykate se qartë rezulton nga këto fatura nuk mund të vërtetohet se të njëjtat janë pranuar nga debitori pasi që të njëjtat nuk janë nënshkruar dhe vulosur nga pranuesi – debitori dhe nuk ka dëshmi se të njëjta janë pranuar në ndonjë mënyrë tjetër.

Rrjedhimisht, kjo gjykatë vlerëson se nisur nga fakti se procedura përmbarimore paraqet procedurë formale që i nënshtrohet shqyrtimit formal të dokumenteve përmbarimore dhe/apo atyre të besueshme, rrjedh se si kusht esencial mbi bazën e së cilës mund të lejohet përmbarimi janë tiparet e përmbarueshmërisë së dokumentit të besueshëm e të cilit në rastin konkret i mungojnë kushtet nga Neni 29 par.3 dhe 37 i LPP-së. Së këndejmi, Gjykata thekson se pa plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit përmbarues sepse rezulton se debitori nuk e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbarimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbarimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimit, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkalles së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.nr.36/24 datë 28.02.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha